



P Z A P
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.240/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret; Hajriz Hoti kryesues, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë (LVV), të paraqitur kundër Subjektit Politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë; 30.01.2025, merr këtë,

V E N D I M

I. Pranohen si të bazuara ankesat e Subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.240/2025, Anr.241/2025, dhe Anr.242/2025, të datës; 29.01.2025.

II. Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënim i gjelbër më gjobë në lartësi prej 10.000.00 (dhjetëmijë) euro.

III. Detyrohet Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë; 29.01.2025 PZAP-i ka pranuar ankesat nga Subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.240/2025, Anr.241/2025, dhe Anr.242/2025, të datës; 29.01.2025, në të cilat pretendohet se më datë 28 Janar 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë, ka identifikuar se në rrjetin social facebook të mbështetësve, Musli Obria në Illogarinë të rrjetit social Facebook, ka shkruar "PDK, ta ha zemrën, nuk lejojmë ne Albin Kurva pederica në Skenderaj" dhe mbështetësi, Rasim Brahim Rexhepi, ka shkruar se "Pushteti tu deponu dosje kundër çlirimtarëve Mimoza tu fol me Raidoçiqin serbisht kundër veteranëve, e sot në Skenderaj tu knu e tu kcy e tu provoku situatën, masa nuk pyet nuk ban me jan qu dur e gishta se drenicaku e merr tubimin, len shpirtin e ndeshkun rahat mani fushatat qysh i ka hije mu majte jo me pru kurva e loparë e me bo budallakina me qu dorë gishta. Drenicë krenohem me ty edhe kur je ne vësliteresi të uixitjes". Më tej në ankesa pretendohet se i njëjti ka shkruar mbi foto ku shihet Albin Kurti, Aleksandër Vucic, "Drejtori i Institutit pro-rus që nxjerr fitues VV-në me Albin Kurtin dhe Aleksander Vucicin".

Me këtë sipas parashtruesit te ankesës është bërë shkelje e rëndë e Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, respektivisht nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11. Si provë që dëshmon shkeljen e pretenduar ka bashkangjitur fotografi nga postimet në rrjetin social facebook.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga subjekti politik PDK, thekson se fillimi, para se të trajtojmë meritat e ankesës, e shohim si të rëndësishme për të shqyrtuar çështjen e afatshmërisë së ankesës, pasi që siç mund të vërehet, ankuesi nuk i ka bashkëngjitur si dëshmi asnjë provë me të cilën argumentohet koha në të cilën ka ndodhur shkelja e pretenduar, pasi që në vështrim të provës së bashkëngjitur, dëshmohet vetëm që postimi të jetë shpërndara para 22 orësh, mirëpo nuk mund të vërtetohet koha se kur është bërë Screenshoot, andaj si i tillë është e pamundur që të vërtetohet se në cilën kohë ka ndodhur shkelja e pretenduar në ankesë. Më tej në përgjigje thuhet se PDK, në asnjë mënyrë nuk e konteston faktin se veprimet e z. Rasim Brahim Rexhepi përbejnë përdorim të gjuhës që nxit ose provokon, ose që mund të nxise ose provokojë një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë, për të cilat vlerësojnë se padyshim përbejnë veprime të ndaluara.. Mirëpo, konsiderojnë se ankuesi nuk ka arritur që të argumentoj përgjegjësinë subjektive ndaj subjektit politik PDK, pasi që siç do të vërej kolegji i nderuar i panelit, ankuesi me asnjë provë më pak ka arritur që të bëj ndërlidhjen e veprimeve të z. Rasim Brahim Rexhepi, me përgjegjësinë e subjektit politik PDK, mirëpo është mjaftuar vetëm me pretendimin se i njëjtë është djali i vëllait i asamblistit, Fikret Rexhepi ne Skenderaj. Në këtë mënyrë, LVV ka tentuar të bej ndërlidhjen në mes z. Rasim Brahim Rexhepi dhe subjektit politik PDK vetëm për faktin se një familjar i tij (djali i axhës) është asamblist në Komunën e Skenderajt.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat Anr.240/2025, A.nr.241/2025, dhe A.nr.242/2025 të paraqitura me datë; 29.01.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.240/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti politik LVV, kundër subjektit te njëjtë politik PDK, si për nga përbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura nga ankesat.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, vëren se ankesat janë të bazuara.

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës të ofruar si provë materiale, nga e cila rrjedh se Rasim Brahim Rexhepi mbështetës i subjektit politik PDK nëpërmes rrjetit social facebook, ka theksuar, ‘*Pushteti tu deponu dosje kundër çlirimtarëve Mimoza tu fol me Raidoicin serbisht kundër veteranëve, e sot në Skenderaj tu knu e tu kcy e tu provokuu situatën, masa nuk pyet nuk ban me janu qu dur e gishta se drenicaku e merr tubimin, len shpirtin e ndeshkun rahat mani fushatat qysh i ka hijemu majte jo me pru kurva e loparë e me bo budallakina me qu dure gishta. Drenicë krenoliem me ty edhe kur je ne vësliteresi të uxitjes*’. Gjithashtu ka postuar foto ku shihet Albin Kurti, se bashku me Aleksandër Vucic me shkrim “*Drejtori i Institutit pro-rus që nxjerr fitues VV-në me Albin Kurtin dhe Aleksander Vucicin.*” Kurse Musli Obria ka pastuar foto në sheshin e Skenderaj, duke theksuar se “*PDK TA HA ZEMREN NUK LEJOJM NE ALBIN KURVA E PEDERICA NE SKEDERAJ*”

Sipas Panelit vendosja përdorimi i kësaj gjuhe nga simpatizantët e subjektit politik të PDK-së, PDK Rasim Brahim Rexhepi, dhe Musli Obria, në kuadër të fushatës zgjedhore, konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, ngase veprimi i marrë në kohë të fushatës zgjedhore ka për qëllim të krijojë një lidhje negative ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe krijoj atmosferë tensioni dhe përçarje. Veprimet i tilla interpretohen si një përpjekje për të manipuluar perceptimin e votuesve, duke krijuar një lidhje negative mes një partie politike dhe një figure politike të përfolur. Kjo mund të shihet si një mënyrë për të përdorur figura të njoitura për të stigmatizuar një subjekt politik dhe për të rritur ndjenjat negative kundrejt tij. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët dhe simpatizantët janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime që mund të sjellin pasiguri apo të përkqësojnë atmosferën politike. Përdorimi i figurave të tilla të përfolura mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrissë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë.

Përdorimi i një gjuhe të tillë, sipas vlerësimit të Panelit është në kundërshtim me nenit 34 paragrafi 1 pika l.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet “*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërisë si në vijim: ... l) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografji, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*”.

Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të janë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Me nenin 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, është përcaktuar se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet “*të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000 €) Euro.*”

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje, dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë, që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Andaj Paneli vëren se gjuha e përdorur është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektit Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ka pasur parasysh edhe praktikën e mëhershme për rastet të ngjashme si dhe faktin që subjekti politikë në fjalë ka bërë shkelje të natyrës së njëjtë e për të cilat shkelje paneli ka shqiptuar dënlime me gjobë.

Paneli ka vlerësuar edhe pretendimet nga përgjigja në ankesë, mirëpo të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara, për faktin se subjekti politik PDK të njëjtat pretendime nuk i ka provuar me asnje provë të vetme.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), nen 118 paragraf 1 dhe nen 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A.nr.240/2025, datë;30.01.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.36/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija - Ymeri, kryetare e kolegit, Rrustem Thaqi dhe Milena Djeric, anëtar të kolegit, duke vendlorur sipas ankesës së subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.240/2025, të datës 30.01.2025, në seancën e mbajtur më datë 05.02.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEȚT ankesa e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, ndërsa vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.240/2025, i datës 30.01.2025, VERTETOHEȚ.

A r s y e t i m i

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa Anr.240/2025, të datës 30.01.2025, është vendlorur: I. Pranohen si të bazuara ankesat e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.240/2025, Anr.241/2025, dhe Anr.242/2025, të datës 29.01.2025. II. Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënim i gjelbëri më lartësi prej 10.000€. III. Detyrohet subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, që gjelbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Kundër vendimit të lartpërmendorur, subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke pretenduar se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së, dhe vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike, duke propozuar që Gjykata Supreme të aprovojë ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, si të bazuat, ndërsa të anulohet vendimin A.nr.240/2025, i datës 30 janar 2025, i nxjerrë nga PZAP dhe të refuzohen si të pabazuara ankesat A.nr.240/2025 dhe A.nr.241/2025, të ankuesit Lëvizja



Vetëvendosje, pasi që nuk është arritur të argumentohet përgjegjësia subjektive e Partisë Demokratike të Kosovës.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendor, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e subjektit politik të dënuar me këtë vendim të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi A.nr.55/2025, i datës 19.01.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 29.01.2025 PZAP-i ka pranuar ankesat nga subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.240/2025, Anr.241/2025, dhe Anr.242/2025, të datës 29.01.2025.

Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë të subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), PZAP-i, ka nxjerr vendimin Anr.240/2025, të datës 30.01.2025, me të cilën e ka aprovuar ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), duke vendosur si në dispozitiv të vendimit të ankimuar.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës të ofruar si provë materiale, nga e cila rrjedh se Rasim Brahim Rexhepi mbështetës i subjektit politik PDK nëpërmes rrjetit social facebook, ka theksuar, “Pushteti tu deponu dosje kundër çlirimtarëve Mimoza tu fol me Raidoçiqin serbisht kundër veteranëve, e sot në Skenderaj tu knu e tu kcy e tu provoku situatën, masa nuk pyet nuk banë me jau qu duar e gishta se drenicaku e merr tubimin, len shpirtin e ndeshkon rahat mani fushatat qysh i ka hije mu majtë jo me pru kurva e loparë e me bo hudallakina me qu dorë gishta. Drenicë krenohemi me ty edhe kur je në vështirësi të nxitjes”. Gjithashtu ka postuar foto ku shihet Albin Kurti, se bashku me Aleksandër Vucic me shkrim “Drejtori i Institutit pro-rus që nxjerr fitues VV-në me Albin Kurtin dhe Aleksander Vucicin.” Kurse Musli Obria ka pastuar foto në sheshin e Skenderaj, duke theksuar se “PDK ta ha zemrën nuk lejojmë ne Albin kurva e pederica në Skenderaj”.

Sipas Panelit vendosja përdorimi i kësaj gjuhe nga simpatizantët e subjektit politik të PDK-së, PDK Rasim Brahim Rexhepi, dhe Musli Obria, në kuadër të fushatës zgjedhore, konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, ngase veprimi i marrë në kohë të fushatës zgjedhore ka për qëllim të krijojë një lidhje negative ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe krijoj atmosferë tensioni dhe përcarjeje. Veprimet i tilla interpretohen si një përpjekje për të manipuluar perceptimin e votuesve, duke krijuar një lidhje negative mes një partie politike dhe një figure politike të përfolur. Kjo mund të shihet si një mënyrë për të përdorur figura të njohura për të stigmatizuar një subjekt politik dhe për të iritur ndjenjat negative kundrejt tij. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët dhe simpatizantët janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe



të shmangin veprime që mund të sjellin pasiguri apo të përkeqësojnë atmosferën politike. Përdorimi i figurave të tilla të përfolura mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë.

Përdorimi i një gjuhe të tillë, sipas vlerësimit të Panelit është në kundërshtim me nenit 34 paragrafi 1 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet “*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërisë si në vijim: ... 1) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografji, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*”.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje, dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë, që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me dënimin e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsyë të mjaftueshme përfaktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, sepse në mënyrë të sigurt është vërtetuar shkelja nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatet, e paraparë në nenin 34, 1.11, të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenit 24.9.1 të Rregullores nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave. Vendimi i kundërshtuara nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme ishin pretendimet ankimore të subjektit politik të lartpërmendur, dhe përkizazi me konstatimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike ashtu si thekson parashtruesi i ankesës dhe se këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim nga kolegji i kësaj gjykate refuzohen si të pabazuara dhe jo të qëndrueshme sepse PZAP vendimin e saj e bazon në prova konkrete të qarta dhe ekzistuese të cilat gjenden në shkresat e lëndës, që ka vërtetuar pretendimet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor dhe janë në lindhshmëri me rastin që është objekt i shqyrtimit konkretisht deklarimet ku theksohet se:



“Pushteti tu deponu dosje kundër çlirimtarëve Mimoza tu fol me Raidciçiqin serbisht kundër veteranëve, e sot në Skenderaj tu knu e tu kcy e tu provoku situatën, masa nuk pyet nuk banë me jau qu duar e gishta se drenicaku e merr tubimin, len shpirtin e ndeshkon, rahat mani fushatat qysh i ka hije mu majtë jo me pru kurva e loparë e me bo hudallakina me qu dorë gishta. Drenicë krenohemi me ty edhe kur je në vështirësi të nxitjes”. Gjithashtu ka postuar foto ku shihet Albin Kurti, se bashku me Aleksandër Vucic me shkrim “Drejtori i Institutit prorus që nxjerr fitues VV-në me Albin Kurtin dhe Aleksander Vucicin.” Kurse Musli Obria ka pastuar foto në sheshin e Skenderajit, duke theksuar “PDK ta ha zemrën nuk lejojmë ne Albin kurva e pederica në Skenderaj, me çka është shkelur Kodi e Mirësjelljes dhe në veçanti nenin 34. 1.11. ku parashihet se: “*1 Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalojen nga bërja e ndonjërsi si në vijim: 1.11 përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografji, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*”.

Gjykatës Supreme i rezulton se gjuha e tillë e përdorur në kuadër të fushatës zgjedhore, paraqet shkelje të Kodit të Mirësjelljes dhe për këtë arsy e aprovon qëndrimin e PZAP-së lidhur me shkeljen dhe lartësinë gjobës. Kjo përfaktin se PZAP-i, me rastin e shqiptimit të gjobës së lartpërmendur, ka marr parasysh një mori rrëthanash të precizuara më afér në arsyetimin e vendimit të tij, dhe se lartësia e gjobës e paraparë për një shkelje të tillë sipas nenit 120 paragrafi 1 pika 3, të Ligjit për zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nr.08-228, është deri në 50.000 €, Gjykata Supreme vlerëson se dënim i shqiptuar këtij subjekti politik në lartësi prej 10,000 €, është i drejtë dhe i ligjshëm, përfaktin se çështja ka të bëjë edhe me recidivizëm, sepse ky subjekt politik është gjobitur edhe më herët për gjuhë të pa përshtatshme në fushatë zgjedhore, prandaj me lartësinë sa i përket gjobës së shqiptuar vlerësohet se do të arrihet qëllimi ligjor i tij, jo vetëm ndëshkimi i shkelësve të dispozitave të Kodit të Mirësjelljes të subjektit politik, mbështetësve dhe kandidatëve të tyre, por edhe korrekτimi i shkeljeve të ndryshme zgjedhore dhe sigurimi i mbarëvajtjes së këtyre dhe zgjedhjeve të tjera, si dhe ndikimi edhe në subjektet e tjera politike që garojnë në zgjedhje, që me përpikëri të zbatojnë dispozitat e Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës..

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme pretendimet e subjektit politik për formën dhe përmbajtjen e vendimit janë të pabazuara përfaktin se, vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përban arsyet e mjaftueshme përfaktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, e cila konstatoi se në rastin konkret edhe e drejta materiale, po ashtu është zbatuar drejt.

Pretendimet sa i përket faktit se PZAP, nuk e ka arritur të argumentoj përgjegjësin subjektive ndaj subjektit politik PDK, Gjykata Supreme vlerëson se një pretendim i tillë është i pa bazuar. Në këtë rastë PZAP, drejtë ka vendosur kur e ka shpallur përgjegjëse subjektin politik PDK, përfaktin se nga provat që gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se pësonat që kanë përdorur gjuhë të urrejtjes dhe gjuhë denigruese, janë mbështetës të subjektit politik PDK, prandaj një vlerësim i tillë që të shpallët përgjegjës ky subjekt politik nga ana e PZAP-së, është i drejtë dhe i ligjshëm.



Në raport me pretendimet se subjekti politik PDK, në mënyrë të vazhdueshme ju ka bërë thirrje mbështetësve të tyre që të përbahen nga përdorimi i gjuhës fyeze, denigruese dhe që ngjallin urrejtje dhe të njëjtit janë ftuar ti respektojnë rregullat zgjedhore, Gjykata Supreme vlerëson se ky veprim i ndërmarr nga ky subjekt politik, është i mirëseardhur dhe i njëjti kontribuon në mbarëvajtjen e drejtë të procesit zgjedhorë, mirëpo i njëjti veprim nuk e liron nga përgjegjësia, sepse në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje të rregullave zgjedhore dhe me të drejtë PZAP, ka shqiptuar gjobën, të cilën e mbështet edhe kjo gjykatë.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtuesit të ankesës, prandaj, pretendimet në ankesë lidhur shkeljen e Kodit dhe me gjobën e shqiptuar u refuzuan si të pa bazuara sepse si të tilla nuk dëshmuant se përbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet anesa që të prezantohen fakteve të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, 120.1.3 dhe 34.1 (11), të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.36/2025, datë 05.02.2025.

Kryetarja e kolegjit,
Franciska Zhitija - Ymeri



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
**SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TACNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE**


Punëtori i autorizuar
Ovlašteni radnik